

Piloti i vogël shqiptar, talent që shkon rrugës së Schumacher-it

Kur të rritem, do të më shihni në formula 1, thotë Gjergj Haxhiu

Rezultatet e Gjergjit gjatë këtij viti nisin me kampion të Zvicrës në Romandi (Pjesa franceze e Zvicrës), Vendi i dyti në "Bridgstone-Cup". I treti në kampionatin zviceran dhe kampion në "Championscup"

Bekim Avdyli

Kontaktin e parë me këtë sport e ka pasur sa ishte 6 vjeç, tregon e ëma e tij, Lejla. "Ishim në një qendër të madhe sportive, ku ndër të tjera ekziston edhe mundësia për karting. Gjergji aty ka pasur kontaktin e parë dhe përkundër vullnetit të tij për të provuar apo bërë një gjiro, nuk i është lejuar për shkak të moshës së re, sepse pa i mbushur shtatë vjet nuk lejohej ngasja e kartingut. Që nga ai moment, Gjergji ka kërkuar vazhdimisht ta dërgojmë në këtë qendër. Duke parë vendosmërinë dhe dashurinë e tij ndaj kësaj makine jo dhe aq te zakonshme, ne vendosem t'ia plotësojmë këtë dëshirë, që padyshim, siç thotë i ati, Shkumbin Haxhiu nga Prishtina e ka të trashëguar nga unë. "Familjarisht, babë e babagjysh jemi marrë në Prishtinë me automobilizëm. Kemi qenë mekanikë dhe unë jam "shpengler" - e kemi dashur këtë profesion e këtë sport gjithmonë" tregon ai

Gjergji ka lindur më 30. korrik 1999 në Bussigny, është nëntë vjeç dhe flet me ëndje e i koncentruar rreth kartingut e formulave. Numri 30 thotë tregon ditëlindjen time. Kartingun e kam 60 cm (kubik) dhe për të punojnë gjashtë kuaj fuqi. Tek ai vërehet dashuria që ka për kartingun dhe automobilizmin në përgjithësi, dhe mënyra se si flet ky vogëlush për funksionin dhe garat në pistë me kartingun e tij, të lë gojëhapur, veçmas ata që nuk e njohin ende këtë sport. "A e di", thotë ai, i kam gomat të markës Bridgstone", t'giona janë. T'mira janë dhe nëpër shi janë shumë të sigurta". I pyetur për pilotët dhe garat e formulës një, Gjergji ende pa mbaruar pyetja, kërcen e thotë. "Po, po e di -Shumaheri dhe Ferrari i tij, një nga kopjet e tij e kam në shtëpi, (tregon këtu për Ferrarin, lodër që e ka në dhomën e tij), "amo unë e du Hamiltonin dhe një ditë mendoj të bëhem si ai -edhe ma shumë se ai!"

Shpejtësia deri 90 km në orë nuk më ka frikësuar asnjëherë. "Po unë vetë i kom ngrah 90 kilometra n'orë, edhe nuk jom tutë hiq", tregon duke qeshur ndërsa kthesat, thotë, janë deserti im, i marr pa frenuar.

Sport i shtrenjtë!

Ky sport siç shpjegojnë prindërit e Gjergjit, e ëma nga Shkupi dhe i ati nga Prishtina, është shumë i shtrenjtë. Kështu siç jemi ne, me ekip -na ka kushtuar deri më tash mbi 30 mijë franga. Mirëpo e tëra varet nga vetë i interesuari se si dëshiron të marrë pjesë. Ta zëmë vetë apo me ekip. Gjergji është i regjistruar në ekipin e Romandisë, në kampionatin zviceran. Sivjet i ka pasur 6 paraqitje në kategorinë Mini, të cilat ndahen në bazë të moshës dhe madhësisë së motorit të kartingut. Kategoria Mini është deri në 90 kilogram -kartingu bashkë me pilotin. Ndërsa nga mosha 10 vjeç Gjergji mund të ngritet në kategorinë Super-Mini. Kategoria më interesante është ajo KF3 apo siç njihet e juniorëve, që nisë prej moshës 13 vjeç, ku siç thotë Beni (nofka e Shkumbinit), kjo kategori është shumë intere-



Një "grumbull" kupash në dhomën e Gjergjit



Gjergji, i mërzitur, pas një humbjeje

sante dhe e përmasave ndërkom-betare. Këtu fillojnë garat evropiane dhe pjesëmarrja në kampionate botërore, ku nevojiten patjetër sponsorët për të mbuluar shpenzimet të cilat kërcëjnë në lartësinë "astronike", që nënkupton shumë e mbi 200 mijë frangave po që se merr pjesë në gara ndërkombëtare. Duke përfshirë këtu mirëmbajtja, kompletimi i ekipit, posedimi i disa kartingëve që duhet ndërruar e pasur në dispozicion dhe shpenzime që nevojiten për kompletimin e ekipit. "Kur ti kesh këto, dihet e mund të vlerësohet talenti i tij. Kjo kategori në njëfarë mënyre tregon se ku e sa ka gjasa piloti të arrijë të futet në formula tre, dy dhe në grupin elitë, formula një, fat i cili takon jo më shumë se njëzet pilotëve nga mbarë bota", tregon Beni i vetëdijshëm për sfidat që e presin djalin e tij, Gjergjin.

Për më tepër, kartingu kuptohet si shkollë parapërgatitore e pilotëve të rinj; si bazë e automobilizmit për ata që synojnë të bëhen pilot. Fillet e një piloti, baza domethënë, ia nisë në karting. Krejt ata pilotë që ne sot i njohim e që kanë bërë emër në formulën një, kanë kaluar rrugës që po e ndjek Gjergji, i cili deri para pak kohe ka qenë i regjistruar në klubin e Romandisë, kurse tani bën pjesë në grupin e Bernës. Mirëpo kjo nuk është edhe aq e rëndësishme. Përmes klubit ke licencën apo të drejtën për të

shtunën janë provat e lira. Të dielën në mëngjes prapë edhe njëherë mbahen provat e lira 10 minuta dhe mandej është kronometri që nënkupton pole-pozicionin dhe e tëra mbahet në tri pjesë. Ballafaqim i parë i ka dhjetë gjiro, i dyti njëmbëdhjetë dhe finalja pesëmbëdhjetë gjiro. Pjesa e parë dhe e dytë vlen dhjetë pikë ndërsa finalja 20 pikë. Kurse brenda vitit mbahen rreth 18-19 gara, në Zvicër, Itali, Francë. Dhe, përveç kësaj, ekziston edhe Bridgstone-Cup, ku mblidhen pilotët nga mbarë Evropën. Ndërsa çmimet nuk janë shumë të mëdha. Përveç kupës, thotë Gjergji, "masanej i kom marrë edhe do pare, po mi ka marrë babi...". Vetëm sivjet nga pesëmbëdhjetë paraqitje, nëntë i ka mbyllur në vendin e parë.

"Unë dua vetëm vendin e parë!"

Dhe përderisa ne flasim me prindërit e Gjergjit për numrin e fitoreve, ai ndërhyr e i rikujton prindërit; "A di, edhe në Itali në Chiavena kom fitu. I kom mujt italianët". Unë dua vetëm vendin e parë, nuk dua të jem i dyti apo i treti, thotë Gjergji. Mirëpo, pavarësisht dëshirës për të fituar çdo garë, Gjergji ka provuar edhe anën e hidhur, kur pak para finishit, ka humbur një garë në të cilën ka prirë gjatë gjithë kohës. "në Championscup, kom qenë i pari edhe Edi (një shqiptar tjetër, kushëri i tij. Janë të vetmit shqiptarë pilotë, të tjerë nuk dihet që ka) ka ardhë se ka pas do es (kthesa sikurse shkronja S-rrugë gjarpërore) dhe unë mas pari kom shku qeshu (tregon me dorë) edhe ai ma ka mshu, ma ka shty e masanej dhe mu më ka dalë kartingu në bari, dhe kam mbyllur garën në vendin e katërt. "Më ka vluar gjaku dhe hiq s'kam qenë i lumtur, madje edhe kam garë, tregon ai, kësaj here në gjuhën frënge, sepse shprehej më lehtë.

Njëherë, vazhdon ai, për një garë tjetër, "Ishte kohë me shi dhe ne po bënim gjiron e fundit në vijë të drejtë para se te futemi në kthesë,



Shampanjë për vendin e parë

kundërshtari im ma zuri rrugën... në shi duhet mi marrë kthesat në anën e brendshme dhe unë jom hi, masanej e kuptova që muj me rrrshit dhe shkova pak n'bari atje dhe para daljes nga kthesa e tejkaloja dhe e zura vendin e parë". Kurse e ëma plotëson se në Milano ka ndodhur kjo garë që po flet Gjergji -kur e ka tejkualuar kundërshtarin, i ka befasuar të gjithë shikuesit, sepse askush nuk priste më që në gjiron e fundit, pak para finishit, ta tejkaloje një pilot me përvojë të madhe në karting.

Babai i Gjergjit, njëkohësisht është edhe trajner dhe kur janë në pistë, siç tregon Gjergji, ai është i "shtirë", më bërtet e kërcen t'i jap më shumë gaz, të cilën kërkesë, shton Beni, e përmbush me kënaqësi, sepse kartingu është jeta e tij. Ai jeton me të, ka dhomën e mbushur me formula e karting, mendon e mezi pret të vijë pranvera e t'i kthehet pistës. "Kur të rritem do të jem pilot në formula një", thotë Gjergji. Ata që kanë pasur rastin ta shohin në pistë, e vlerësojnë shumë mirë. Janë të befasuar me guximin dhe taktikën e tij ngasëse. Ai gjithmonë, pavarësisht se ku ka garuar, ka startuar në podium, i pari, i dyti apo i treti. Dhe për këtë më së miri flasin rezultatet e këtij viti: Kampion i Zvicrës në Romandi. Vendi i dyti në "Bridgstone-Cup". I treti në kampionatin zviceranë dhe kampionë në "Championscup".



Gjergj Haxhiu, i pari, me kartingun e tij me numrin karakteristik 30